

Në mbështetje të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Ligji Nr.05/L-038, neni 14 dhe të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr. 446/2, të 11.05.2016, neni 30, Kuvendi i Akademisë, në mbledhjen e mbajtur më 28 qershor 2018 miratoi

Planin strategjik gjithëpërfshirës të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për periudhën 2018 – 2021

Qëllimet strategjike të Akademisë për periudhën 2018-2021

VIZIONI

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm ASHAK), si institucion i pavarur dhe më i lartë shkencor dhe artistik në Kosovë, aspiron përsosmërinë shkencore dhe artistike dhe ndikimin e shkencës, të artit dhe të kulturës në zhvillimin e shoqërisë. ASHAK-u si institucion mëton të reflektojë autoritet, besueshmëri dhe pavarësi, duke u mbështetur në një sistem vlerash të ndërtuar mbi rigozitet shkencor, mendim kritik dhe transparencë. Ndërmerr hapa për rritjen e kontributit të shkencës dhe të artit në krijimin e shoqërisë së bazuar në dije dhe kulturë, si kusht i domosdoshëm për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror. Akademia njëherësh synon ndërlikohen e krijimtarisë shkencore dhe artistike të Kosovës me vendet e tjera në Evropë dhe në botë, duke kultivuar përkujdesje sistematike për trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

MISIONI

ASHAK-u punon për nxitjen, zhvillimin, promovimin dhe avancimin e shkencës dhe të artit në Kosovë, për ndërtimin e një shoqërie të bazuar në dije. Realizon, ideon dhe organizon projekte shkencore dhe artistike me interes për zhvillimin shoqëror, ekonomik e kulturor të Kosovës, përmes: botimit të materialeve kërkimore nga fusha e shkencës, e artit dhe kulturës; mbajtjes së aktiviteteve artistike dhe të diskutimeve kulturore, me qëllim të ngritjes së mendimit kritik në Kosovë; promovimit të mendimit shkencor e artistik në Kosovë, dhe përfshirjes së këtij mendimi në rrjedhat globale.

OBJEKTIVAT

Qëllim i Akademisë është zhvillimi, nxitja, promovimi dhe avancimi i shkencës dhe të artit në Kosovë përmes:

1. Realizimit të projekteve shkencore me interes për zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit;
2. Kujdesit për krijimin dhe avancimin e kuadrove shkencore, sidomos të brezit të ri;
3. Mbledhjes, sistemimit, ruajtjes dhe studimit të materialeve me interes të veçantë shkencor, sidomos të atyre që lidhen me trashëgiminë kulturore dhe të kaluarën e Kosovës;
4. Pjesëmarrjes në formimin e politikave të veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike;
5. Vlerësimit të gjendjes ekzistuese dhe propozimit të masave për avancimin e mendimit shkencor dhe ngritjen e cilësisë së krijimtarisë artistike;
6. Shqyrtimit të problematikës së përgjithshme nga fushat e veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike;
7. Organizimit të punës kërkimore-shkencore me karakter teorik e praktik në fusha të ndryshme të dijes dhe të arteve në formën e tubimeve, të tryezave, të këshillimeve, të simpoziumeve, të konferencave shkencore dhe të formave përkatëse të shprehjes së krijimtarisë dhe aktiviteteve artistike;
8. Botimit të publikimeve të rregullta dhe periodike nga fusha e shkencës dhe e artit, që financohen nga buxheti i Akademisë;
9. Bashkëpunimit me institucionet e Republikës së Kosovës dhe me institucionet ndërkombëtare nga fusha e shkencës dhe e artit;
10. Ndihmës për përhapjen e mendimit shkencor dhe të krijimtarisë artistike jashtë vendit;
11. Përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të punës të anëtarëve të Akademisë;
12. Zhvillimit të hulumtimeve me interes të veçantë publik e shkencor;
13. Ndërmarrjes së veprimeve në interes të veçantë për Kosovën, në mbështetje të së drejtës dhe të detyrimit të Akademisë për të qenë institucion këshillues për zhvillimin e shkencës dhe të artit në Kosovë, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit.

MASAT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE

1. REALIZIMI I PROJEKTEVE SHKENCORE ME INTERES PËR ZHVILLIMIN SHOQËROR, EKONOMIK DHE KULTUROR TË VENDIT

Për realizimin e këtij objekti strategjik, rëndësi të veçantë kanë kontributi i seksioneve të ASHAK-ut dhe potenciali njerëzor, shprehur me veprimtarinë botuese, shkencore dhe artistike, mbështetur në infrastrukturën materiale.

Masat për realizimin e pikës 1

- 1.1 Realizimi i projekteve kërkimore shkencore dhe artistike të ASHAK-ut;
- 1.2 Forcimi i bashkëpunimit në projekte të përbashkëta me institucionet e tjera kërkimore shkencore dhe artistike, si dhe pjesëmarrja në burimet vendore dhe ndërkombëtare të financimit;
- 1.3 Forcimi i bashkëpunimit me universitetet publike, institutet shkencore, institucionet kulturore dhe institucionet e tjera; dhe
- 1.4 Pjesëmarrja në projektet shkencore e kulturore-artistike, përforcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe pjesëmarrja në projektet shkencore dhe artistike evropiane.

2. KUJDESI PËR KRIJIMIN DHE AVANCIMIN E KUADROVE SHKENCORE TË BREZIT TË RI

Do t'i kushtohet vëmendje e veçantë krijimit dhe avancimit të kuadrove të reja shkencore dhe artistike, duke promovuar shkallën e cilësisë së projekteve shkencore dhe artistike, me të cilat të rinjtë inkurajohen për punë në këto fusha, ngritjen e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve institucionale dhe materiale për arritjen e rezultateve relevante shkencore e artistike. Ky objektiv strategjik mund të realizohet bazuar në një sistem të vlerave ku zbatohen indikatorët ndërkombëtarisht të pranuar. ASHAK-u do të jetë pjesë e përpjekjeve të përgjithshme për tejkalimin e faktorëve kufizues që paraqesin pengesa për përfshirjen e femrave në fushën e shkencës dhe të artit.

Masat për realizimin e pikës 2

- 2.1 Bashkëpunimi me universitetet, me institutet shkencore e kulturore, dhe forcimi i bashkëpunimit me sektorin ekonomik e publik për zhvillimin dhe avancimin e kërkimeve shkencore dhe të veprimtarisë artistike në nivel vendi;
- 2.2 Angazhimi në krijimin e kushteve që mundësojnë njohjen e brezit të ri të shkencëtarëve dhe të artistëve, si dhe vlerësimin e rezultateve kulminante shkencore dhe artistike;
- 2.3 Organizimi i tubimeve shkencore, i aktiviteteve kulturore dhe artistike, si dhe i forumeve për promovimin e shkencëtarëve të rinj rreth temave të rëndësishme për: arsimin, shkencën, artin, liritë akademike dhe artistike; mbështetjen financiare dhe vlerësimin e krijimtarisë shkencore dhe artistike; integritetin dhe cilësinë e kërkimeve shkencore; si dhe publikimin e rezultateve shkencore dhe prezantimin e veprave artistike;
- 2.4 Përfshirja e një rrethi më të gjerë të shkencëtarëve dhe të artistëve të rinj të talentuar në aktivitetet e veta;

- 2.5 Shpërblimi i krijuesve të rinj për të arriturat më të larta shkencore dhe artistike në Kosovë;
- 2.6 Organizimi i tryezave dhe i seminareve shkencore për promovimin e interesimit të të rinjve për shkencën në fushat a në degët e caktuara të dijes, si në matematikë, inxhinieri, gjuhët e Ballkanit dhe veprimtaritë artistike kualitative;
- 2.7 Promovimi i barazisë gjinore dhe i diversitetit, si dhe sigurimi i përfaqësimit të drejtë të tyre në strukturat e ASHAK-ut.

3. MBLEDHJA, SISTEMIMI, RUAJTJA DHE STUDIMI I MATERIALEVE ME INTERES TË VEÇANTË SHKENCOR, SIDOMOS TË ATYRE QË LIDHEN ME TRASHËGIMINË KULTURORE DHE TË KALUARËN E KOSOVËS

Do të bëjë mbledhjen, sistemimin, ruajtjen dhe studimin e materialeve që ndërlidhen me çështjet e identitetit kombëtar, pasuritë natyrore, kulturore, shkencore dhe artistike të Kosovës dhe ato do të prezantohen para opinionit vendor dhe ndërkombëtar. ASHAK-u ka për detyrë që në mënyrë shkencore dhe të argumentuar të përballet me tendencat e zhvlerësimit të identitetit kombëtar dhe të nxjerrë në pah kompleksitetin e këtij identiteti të formësuar në rrethana unike historike.

Masat për realizimin e pikës 3

- 3.1 Konstatimi, studimi dhe promovimi i vlerave të rëndësishme kulturore, historike dhe artistike, të arriturave shkencore, pasurive natyrore, të ngjarjeve dhe të personaliteteve të rëndësishme historike;
- 3.2 Ruajtja, mbrojtja aktive dhe respektimi i traditës, i trashëgimisë kulturore dhe i veçantive të hapësirës kosovare si vlera themelore kombëtare;
- 3.3 Mbrojtja e natyrës nga kërcënimet bashkëkohore të urbanizimit dhe zhvillimit të përgjithshëm ekonomik;
- 3.4 Paraqitja sistematike para opinionit e vlerave të veçanta kulturore, artistike dhe të arriturave shkencore nga e kaluara.

4. PJESËMARRJA NË FORMIMIN E POLITIKAVE TË VEPRIMTARISË SHKENCORE DHE TË KRIJIMTARISË ARTISTIKE

Pjesëmarrja aktive në propozimin, aprovimin dhe zbatimin e politikave shkencore, artistike dhe kulturore në Kosovë, në mënyrë që të realizohet vizioni e të përmbushet misioni i vet në ngritjen e nivelit të përgjithshëm të arsimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik.

Masat për realizimin e pikës 4

- 4.1 Nxitja e përpilimit të dokumenteve strategjike të ASHAK-ut lidhur me çështjet aktuale në shoqërinë kosovare, si: të cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, të edukimit për shoqëri teknologjike, të gjendjes në shkollimin e sotëm dhe vizionit për të ardhmen, të dijes si bazë për një zhvillim konkurrent ekonomik;
- 4.2 Pjesëmarrja këshillëdhënëse e anëtarëve të ASHAK-ut në kuadër të bashkëpunimit të Akademisë me institucionet e vendit;

- 4.3 Pjesëmarrja e anëtarëve të ASHAK-ut në organizatat e rëndësishme shkencore dhe artistike ndërkombëtare; dhe
- 4.4 Këshillimi i paanshëm i bartësve të politikave të arsimit dhe të kulturës në Kosovë nga fusha e ekspertizës dhe e përvojës së anëtarëve të ASHAK-ut.

5. VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE DHE PROPOZIMI I MASAVE PËR AVANCIMIN E MENDIMIT SHKENCOR DHE NGRITJEN E CILËSISË SË KRIJIMTARISË ARTISTIKE

Promovimi i ndërgjegjësimit për rolin fundamental të dijes në progresin e përgjithshëm të shoqërisë ku arsimit i lidhur me kërkime dhe inovacion do t'i kontribuojë shkencës, artit dhe kulturës, do të nxisë kreativitetin dhe do të promovojë standardet më të larta të përsosmërisë, etikës dhe ndershmërisë. Inkurajimi i ndërtimit të personalitetit të bazuar në dije, shkathtësi dhe kompetenca të nevojshme për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, në të gjitha nivelet e arsimit. Kujdesi i theksuar për gjuhën, historinë e kulturën, dhe ruajtjen e të gjitha formave të identitetit kombëtar. Afirmimi i kreativitetit dhe i inovacionit si bazë e zhvillimit të shkencës, artit dhe të të gjitha veprimtarive të tjera shoqërore.

Masat për realizimin e pikës 5

- 5.1 Bashkëpunimi me universitete, institute dhe institucione arsimore, shkencore dhe kulturore në përparimin e vazhdueshëm të të gjitha niveleve të arsimit të drejtuara nga mësimi cilësor i përvetësuar në mënyrë aktive me praktikat profesionale;
- 5.2 Promovimi i sistemit arsimor ku fitohen njohuri për trashëgiminë kulturore vendore, evropiane dhe botërore, si dhe ruajtjen dhe respektimin e kulturës sonë dhe diversitetit kulturor rreth nesh;
- 5.3 Promovimi i krijimit dhe ruajtjes së të mirave të trashëguara kulturore me vlera të përhershme me mbështetje të teknologjive bashkëkohore; dhe
- 5.4 Bashkëpunimi me të gjitha institucionet relevante për organizimin e tryezave shkencore për vlerësimin e gjendjes aktuale dhe përpilimin e dokumenteve strategjike për ngritjen e cilësisë së kërkimeve shkencore dhe vlerave artistike.

6. SHQYRTIMI I PROBLEMATIKËS SË PËRGJITHSHME NGA FUSHAT E VEPRIMTARISË SHKENCORE DHE TË KRIJIMTARISË ARTISTIKE

Përballja me sfidat dhe problemet kombëtare dhe globale, ndërthurur nga dinamika e botës në të cilën jetojmë, të shprehura në programet e ndryshme kombëtare, evropiane dhe të Kombeve të Bashkuara, si: çrrënjosja e varfërisë, sigurimi i jetës së shëndoshë për të gjithë, sigurimi i qasjes në burime të qëndrueshme të energjisë, ndërtimi i vendbanimeve të qëndrueshme dhe zbutja e ndryshimeve klimatike. Kontributi për promovimin e kulturës së kërkimeve shkencore me karakter global dhe të promovojë vetëdijësimin e shoqërisë për sfidat kombëtare dhe globale.

Masat për realizimin e pikës 6

- 6.1 Promovimi i ruajtjes së ambientit në përgjithësi e i burimeve të ujit, të ajrit, të tokës, të pyjeve dhe të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pasurive minerare të Kosovës, në veçanti, përmes projekteve shkencore, publikimeve popullarizuese dhe tryezave shkencore;
- 6.2 Promovimi imperativ i ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe ndikimi në përzgjedhjen e prioriteteve kombëtare politike për rëndësinë e arsimit, të shkencës, të kulturës dhe të artit për qëndrueshmëri të përgjithshme të Kosovës në relacionet globale ndërkombëtare;
- 6.3 Promovimi dhe forcimi i rolit të shkencëtarëve kosovarë, përmes formave të ndryshme të projekteve shkencore vendore, evropiane dhe botërore në përballje konkurruese me trendët globale.

7. ORGANIZIMI I PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE ME KARAKTER TEORIK E PRAKTIK NË FUSHA TË NDRYSHME TË DIJES DHE TË ARTEVE

Nxiti, zhvillimi dhe promovimi i punës kërkimore-shkencore me karakter teorik dhe praktik në fusha të ndryshme të dijes dhe të arteve përmes projekteve shkencore dhe artistike, të botimeve, ekspozitave, të tryezave shkencore dhe të seminareve nga fushëveprimtaria e seksioneve të ASHAK-ut. Kujdesi që resurset kryesore të ASHAK-ut të jenë njohuritë e thella, rezultatet kulmore shkencore e artistike, si dhe kompetenca në shkencë e në art e anëtarëve të saj. ASHAK-u do të përkujdeset të përzgjedhë anëtarë të vet shkencëtarët dhe artistët më të mirë, dhe kjo paraqet pikën më vitale për realizimin e kërkimeve shkencore cilësore, të veprave të artit me vlera të larta, cilësinë e këshillave për politikën e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, si dhe për ndikim të dukshëm në rrjedhat e shoqërisë.

Masat për realizimin e pikës 7

- 7.1 Transparenca në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të saj, të bazuar në merita dhe të arritura shkencore dhe artistike;
- 7.2 Përgatitja e projekteve me dokumentacion të nevojshëm për kërkimin e mundësive për themelimin e instituteve kërkimore-shkencore që do të veprojnë në kuadër të ASHAK-ut;
- 7.3 Angazhimi i shkencëtarëve të institucioneve të tjera në projektet kërkimore të ASHAK-ut;
- 7.4 Propozimi i një sistemi të qëndrueshëm të financimit të bazuar në burimet buxhetore, bashkëpunim me ekonomi, projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, me theks të veçantë në burimet e Bashkimit Evropian;
- 7.5 Organizimi i tubimeve, tryezave, këshillimeve, simpoziumeve, konferencave shkencore dhe formave përkatëse të shprehjes së krijimtarisë dhe aktiviteteve artistike; dhe
- 7.6 Ndikimi në opinionin publik lidhur me shkencën, artin dhe kulturën përmes medie të shkruara dhe elektronike.

8. BOTIMI I PUBLIKIMEVE TË RREGULLTA DHE PERIODIKE NGA FUSHA E SHKENCËS DHE E ARTIT, QË FINANCOHEN NGA BUXHETI I AKADEMISË

Vazhdimi i traditës së pasur në botimin e veprave letrare, shkencore dhe artistike, si dhe në publikimin e revistave periodike, ku promovohen të arriturat në fushën e gjuhësisë, letërsisë, historisë, shkencave shoqërore, shkencave të natyrës dhe në fushën e artit. Me veprimtarinë e vet botuese ASHAK-u kultivon kulturën e cilësisë dhe i promovon të arriturat në të gjitha fushat e shkencës dhe të artit në një rreth më të gjerë.

Masat për realizimin e pikës 8

- 8.1 Pasurimi i fondeve arkivore, bibliotekare, i krijimtarisë artistike dhe i veprimtarisë botuese (revistat shkencore, librat, përmbledhjet e punimeve nga tubimet shkencore) në mënyrë tradicionale dhe elektronike;
- 8.2 Mbrojtja dhe restaurimi i materialeve ekzistuese, mbledhja dhe përpunimi i materialeve të reja, blerja e veprave artistike, librave, dhe avancimi i bazës së të dhënave;
- 8.3 Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacioneve dhe të komunikimeve si dhe të multimedieve që do të mundësojë mbledhjen sistematike dhe digjitalizimin e materialeve dhe dokumenteve;
- 8.4 Rritja e përmbledhjeve digjitale dhe paraqitja e tyre si qasje e hapur në burimet e përmbajtjeve digjitale; dhe
- 8.5 Përpjekje këmbëngulëse për internacionalizimin e botimeve dhe të publikimeve periodike, të përcjella me masat përgjegjëse për ngritjen e vlerave dhe të cilësisë bazuar në parametra të pranuar ndërkombëtarisht;

9. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE ME INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE NGA FUSHA E SHKENCËS DHE E ARTIT

Përkushtimi në theksimin dhe forcimin e rolit të ASHAK-ut, përmes pjesëmarrjes së anëtarëve të vet në bashkëpunim me institucionet e Republikës së Kosovës dhe ato ndërkombëtare në fushën e shkencës dhe të artit. Shprehja e angazhimit të ASHAK-ut me pjesëmarrje në institucionet politikëbërëse dhe ekzekutive, si: Kuvendi i Kosovës; Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë; Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit; si dhe në asociacionet dhe nismat ndërkombëtare akademike.

Masat për realizimin e pikës 9

- 9.1 Pjesëmarrja e anëtarëve të ASHAK-ut në Këshillin Kombëtar të Shkencës;
- 9.2 Pjesëmarrja e anëtarëve të ASHAK-ut në përbërjen e Këshillit Shkencor të MASHT-it, të përcaktuar sipas Ligjit për veprimtari kërkimore shkencore;
- 9.3 Pjesëmarrja e anëtarëve të ASHAK-ut në akademitë dhe organet e akademive dhe të institucioneve akademike dhe shkencore ndërkombëtare.

10. NDIHMA PËR PËRHAPJEN E MENDIMIT SHKENCOR DHE TË KRIJIMTARISË ARTISTIKE JASHTË VENDIT

Ruajtja dhe kultivimi i bashkëpunimit shumëvjeçar në planin ndërkombëtar të bazuar në marrëdhënie bilaterale, dhe përpjekja e vazhdueshme për zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve të shumëfishta me institucionet evropiane dhe botërore, mbështetur në parimet themelore të promovimit të cilësisë, të kontinuitetit, të identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kulturore.

Masat për realizimin e pikës 10

- 10.1 Forcimi i të gjitha formave të bashkëpunimit ndërkombëtar në kërkimet relevante për përmirësimin e ndikimit të shkencës kosovare, të artit dhe të kulturës në hapësirën evropiane dhe botërore;
- 10.2 Formimi dhe zhvillimi i rrjetëzimit të ASHAK-ut me organizatat shkencore dhe profesionale;
- 10.3 Pjesëmarrja në projekte relevante për kërkime shkencore dhe artistike;
- 10.4 Promovimi i publikimeve nga të gjitha fushat e shkencës, të artit dhe të kulturës në gjuhën shqipe. Kërkesa imperative për publikime të punimeve shkencore në gjuhën angleze ose në njërën nga gjuhët botërore, kryesisht në shkencat e natyrës, në mjekësi dhe në shkencat teknike, nuk përjashton imperativin e rëndësishëm të përkujdesjes dhe zhvillimit të gjuhës shkencore shqipe; dhe
- 10.5 Inkurajimi i opinionit intelektual për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe si gjuhë bashkëkohore të shkencës, të artit dhe të kulturës.

11. PËRMIRËSIMI I VAZHDUESHËM I KUSHTEVE TË PUNËS TË ANËTARËVE TË AKADEMISË

Menaxhimi dhe përkujdesja për pasurinë e vet të paluajtshme dhe të luajtshme, rinovimi dhe mirëmbajtja e objekteve të veta duke u përkujdesur për mënyrën racionale të shfrytëzimit. Pasuria e paluajtshme përfshin objektin e ASHAK-ut me hapësirat përcjellëse dhe hapësirën e jashtme. Pasuria e luajtshme përfshin koleksionet artistike (pikturat, skulpturat, grafikët), librat, mobilet antike dhe të tjera.

Masat për realizimin e pikës 11

- 11.1 Rinovimi, rregullimi dhe mirëmbajtja e përhershme e objektit kryesor të ASHAK-ut;
- 11.2 Angazhimi i ASHAK-ut që përmes buxhetit të sigurohen mjetet për mirëmbajtje të vazhdueshme të objektit të ASHAK-ut;
- 11.3 Sigurimi i burimeve financiare shtesë për rritjen e pasurisë së ASHAK-ut me muze, galeri, kopshte botanike etj.; dhe
- 11.4 Ruajtja, konservimi dhe pasurimi i koleksioneve të ndryshme artistike, fondit të librave dhe koleksioneve të tjera.

12. ZHVILLIMI I HULUMTIMEVE ME INTERES TË VEÇANTË PUBLIK E SHKENCOR

Përcjellja e vëmendshme e gjendjes aktuale në shoqëri duke u prononcuar për gjendjen e përgjithshme në sundimin e së drejtës, në arsim, në mbrojtje të ambientit, në shëndetësi, dhe

trajtimi në mënyrë sistematike, gjithëpërfshirëse dhe ndërdisiplinore i shkaqeve të gjendjes ekzistuese në këto fusha.

Masat për realizimin e pikës 12

- 12.1 Promovimi i një zhvillimi të baraspeshuar ekonomik, të bazuar në resurset energjetike dhe minerare të Kosovës;
- 12.2 Pjesëmarrja në ndërtimin e një sistemi të drejtësisë që garanton sundimin e së drejtës për të gjithë si parakusht për sigurinë e përgjithshme;
- 12.3 Pjesëmarrja në hartimin rregullativës dhe të planeve për mbrojtjen e mjedisit dhe të resurseve natyrore;
- 12.4 Pjesëmarrja në hartimin e strategjive për arsimin në Kosovë, duke u bazuar në gjendjen ekzistuese dhe modelet që sigurojnë cilësi të arsimit në të gjitha nivelet; dhe
- 12.5 Pjesëmarrja në formulimin e një sistemi të qëndrueshëm social dhe shëndetësor.

13. NDËRMARRJA E VEPRIMEVE NË INTERES TË VEÇANTË PËR KOSOVËN, NË MBËSHTETJE TË SË DREJTËS DHE TË DETYRIMIT TË AKADEMISË PËR TË QENË INSTITUCION KËSHILLUES PËR ZHVILLIMIN E SHKENCËS DHE TË ARTIT NË KOSOVË, NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E ZHVILLIMIT TË VENDIT

Integrimi i teknologjive bashkëkohore në zhvillimin ekonomik, i cili kërkon kuadro me kualifikime dhe me njohuri të thella nga inxhinieria, eksperimentimi shkencor, analiza e të dhënave, si dhe kuptimi i ndikimit të tyre shoqëror dhe ekonomik. Promovimi i ngritjes së cilësisë së arsimit të bazuar në këto shkathtësi dhe inkurajimi i bashkëpunimit me sektorin ekonomik për zhvillimin e një ekonomie konkurruese në tregun global.

Masat për realizimin e pikës 13

- 13.1 Identifikimi dhe promovimi i shkathtësive optimale për arsimin universitar dhe profesional përmes organizimit të tryezave shkencore, seminareve dhe forumeve me institucionet relevante;
- 13.2 Zhvillimi i opsioneve të mundshme të ndërtimit të lidhjeve më të fuqishme ndërmjet akademikëve, universiteteve dhe industrisë.

KRYETARI I AKADEMISË

Akademik Nexhat Daci